



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 39 Datë 06.05.2010

MBI PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESEM (PBA) 2011-2013 PER
BASHKINE KORCE

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ekzekutivi i Bashkisë Korçë «Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2011-2013 për Bashkinë Korçë», në zbatim të ligjit nr 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore", ligjit nr 9936 dt 26.06.2008 «Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë», në zbatim të Udhëzimit nr. 7/1 datë 22.02.2010 "Për Përgatitjen e Buxhetit Vendor" si dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 22.02.2010 "Për Përgatitjen e Buxhetit të shtetit dhe fondet speciale" mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë tavanet përgatitore të PBA-së 2011-2013 për Bashkinë Korçë sipas tabelës nr. 1 bashkangjitur .
2. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm 2011-2013 për Bashkinë Korçë sipas tabelave bashkangjitur Formulari nr. 1 Parashikimi i të Ardhurave 2011-2013, Formulari nr. 2 Parashikimi i shpërndarjes së Burimeve Financiare për periudhën 2011-2013.
3. Me propozim të Këshilltarëve pika 3 e këtij projekt-vendimi nuk u miratua.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet e Vartësisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari

Gjergji Pendavinji

